



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

RAPORT

MBI REZULTATET E PYETËSORIT STUDENTOR MBI VLERËSIMIN INSTITUCIONAL NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” PËR VITIN AKADEMIK 2024 - 2025

Përgatiti:
Specialist DKSBC
Tea HYKA
Blerim LUSHI

Miratoi:
Drejtore DKSBC
Bujar MUHARREMI

Elbasan, Mars 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Përmbajtja	Faqe
1. Hyrje.....	2
2. Baza Ligjore.....	2
2.1 Ligji i Arsimit të Lartë.....	2
2.2 Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë.....	3
2.3 Urdhër i brendshëm i UE-së.....	3
3. Metodologjia.....	4
3.1 Metodologjia.....	4
3.2 Pjesëmarrja.....	4
3.3 Anonimati i studentit.....	5
3.4 Kufizimet e vlerësimit.....	5
4. Përfundime dhe Rekomandime.....	5
5. Shtojca.....	7
Shtojca nr. 1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	8
1.1 Shpërndarja e pyetësorit sipas programeve të studimit dhe 1.2 Komente të studentëve të përmbledhura.....	8
Tabela 1.3 (në përqindje).....	9
1.4 Paraqitur grafikisht.....	10
Shtojca nr. 2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës	13
2.1 Shpërndarja e pyetësorit sipas programeve të studimit.....	13
2.2 Komente të studentëve të përmbledhura.....	13
Tabela 2.3 (në përqindje)	14
2.4 Paraqitur grafikisht.....	15
Shtojca nr.3. Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë	18
3.1 Shpërndarja e pyetësorit sipas programeve të studimit.....	18
3.2 Komente të studentëve të përmbledhura.....	18
Tabela 3.3 (në përqindje).....	19
3.4 Paraqitur grafikisht.....	20
Shtojca nr. 4. Fakulteti i Shkencave të Edukimit	23
4.1 Shpërndarja e pyetësorit sipas programeve të studimit.....	23
4.2 Komente të studentëve të përmbledhura.....	23
Tabela 4.3 (në përqindje)	24
4.4 Paraqitur grafikisht.....	25
Shtojca nr. 5. Fakulteti i Shkencave Humane	28
5.1 Shpërndarja e pyetësorit sipas programeve të studimit.....	28
5.2 Komente të studentëve të përmbledhura.....	28
Tabela 5.3 (në përqindje).....	29
5.4 Paraqitur grafikisht.....	30
Shtojca nr. 6. Në Nivel institucioni	33
Tabela 6.1 (në përqindje).....	33
6.2 Paraqitur grafikisht.....	34



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

1. HYRJE

Ky raport realizohet në zbatim të politikave të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për sigurimin e brendshëm të cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në **Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 Neni 103**: “*Sigurimi i brendshëm i cilësisë*”, si një ndër masat e marra në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, Pika 3 “*Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, kjo strukturë organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi*” dhe në aktet nënligjore të tij.

Studentët, si fokusi kryesor i Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit, kontribuojnë në mënyrë direkte me vlerësimin e tyre mbi institucionin dhe cilësinë e mësimdhënies. Ky kontribut është burim i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë së shërbimeve institucionale dhe akademike që ofron UE. Ky raport ka për qëllim **vlerësimin institucional** duke identifikuar problematikat, me qëllim përmirësimin e tyre. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport do të jenë një instrument i rëndësishëm për njësitë kryesore me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të strukturave dhe shërbimeve që ofron universiteti.

Raporti ka analizuar të dhënat e përftuara nga realizimi i pyetësorit institucional, viti akademik 2024 - 2025 për programet e studimit me **karakter profesional**, programeve të ciklit të parë të studimeve “**Bachelor**” dhe programeve të ciklit të dytë të studimeve “**Master**” të përmbledhura në pesë shtojca, pjesë përbërëse të këtij raporti, të cilat përkrijnë me Njësitë Kryesore të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (shtojca nr.1);
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës (shtojca nr. 2);
- Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë (shtojca nr. 3);
- Fakulteti i Shkencave të Edukimit (shtojca nr. 4);
- Fakulteti i Shkencave Humane (shtojca nr. 5);

2. BAZA LIGJORE

2.1 Ligji i Arsimit të Lartë

Procesi i anketimit të studentëve është një proces i parashikuar në **Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 datë 22.07.2015, Kreu X, Neni 103** “*Sigurimi i brendshëm i cilësisë*”, sipas të cilit:

1. Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.
2. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e institucionit të arsimit të lartë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

3. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo program studimi.
4. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë.
5. Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

2.2 Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë

Ky raport i referohet edhe standardeve dhe kriterëve për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme, të përcaktuara në **VKM Nr.824, datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”**, si përmbledhje e standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë, për programet e studimit me **“Karakter profesional”**, programet e ciklit të parë të studimeve **“Bachelor”**, programet e studimit të ciklit të dytë **“Master profesional”**, **“Master i shkencave”**.

2.3 Urdhër i brendshëm i UE-së

- Në mbështetje të Ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 24 i Statutit të UE-së, Vendimit të Senatit Akademik nr. 26, datë 27.07.2021 “Për miratimin e përbërjes së komisionit të përhershëm në nivel institucional për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit”, Komisioni i Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit miratoi formatin dhe modalitetet e pyetësorit institucional të studentëve “Për vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, për vitin akademik 2024 - 2025”.
- Urdhëri i Rektorit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” Nr. 02, datë 10.01.2025 “Për vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, për vitin akademik 2024 - 2025”.
- Detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin prej pozicionit të përcaktuara në *Vendimin Nr 49 datë 13.11.2021 të Bordit të Administrimit “Për Miratimin e Strukturës të Përgjithshme të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”*, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka këto detyra:
 - Evidenton dhe ndjek problematikat e lidhura me cilësinë e mësimdhënies
 - Bën vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore
 - Organizon dhe ndjek zhvillimin e pyetësorit studentor institucional dhe pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

3. METODOLOGJIA

3.1 Metodologjia

Metodologjia e studimit është sasiore dhe instrumenti i përdorur është pyetësi i miratuar nga Komisioni i Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit.

Pyetësi institucional përmban **22 pyetje** të mbyllura, **18 pyetje** të mbyllura janë me nga katër (4) alternativa secila: *Dobët, Mirë, Shumë mirë dhe Nuk e di*, kurse **4 pyetje** të mbyllura janë me nga katër (4) alternativa secila: *Aspak, Pak, Shumë mirë dhe Nuk e di*, si dhe **6 pyetje** të hapura. Në pyetjet e hapura studentëve u kërkohet të shprehin mendimin e tyre dhe të japin sugjerime lidhur me shërbimet që ofron institucioni. Duke qenë fakultative, jo të gjithë studentët pjesëmarrës në pyetësor i janë përgjigjur pyetjeve të hapura.

Përgjigjet për çdo pyetje të mbyllur janë gjeneruar në përqindje. Përgjigjet e hapura të studentëve kanë shërbyer si bazë për dhënien e rekomandimeve përkatëse ose evidentimin e praktikave më të mira. Përpos përpunimit statistikor të pyetjeve të mbyllura, për çdo njësi kryesore, është bërë dhe përpunimi statistikor në nivel institucioni, si dhe janë paraqitur në mënyrë grafike.

3.2 Pjesëmarrja

Në raport janë pjesëmarrës studentë të programeve të studimit me karakter profesional, të ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimeve të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Për të garantuar një pjesëmarrje dhe njohje sa më të mirë me procesin, studentët u mirëinformuan nga stafi ndihmësakademik i Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë që shoqërohej nga Zv. Dekani përkatës i njësive kryesore, në lidhje me kohën e kryerjes së pyetësorit, llojin e pyetësorit dhe rëndësinë e këtij procesi, para fillimit të procesit, në takimet e drejtëpërdrejta në auditor.

Përzgjedhja për plotësimin e pyetësorit institucional ka qenë rastësore, me qëllim gjithëpërfshirjen. Nisur nga numri i pyetësorëve të plotësuar, rezulton se numri i studentëve që kanë plotësuar pyetësorin institucional paraqitet si më poshtë:

Nr.	Në nivel Njësie Kryesore:	Plotësuar
1.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	500
2.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	291
3.	Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë	252
4.	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	240
5.	Fakulteti i Shkencave Humane	130
• Në nivel Institucioni		1413

Target grup (numri i pyetësorëve) për Njësi Kryesore është llogaritur me numrin e studentëve për Njësi Kryesore/ numri i studentëve gjithsej. Janë realizuar **1413** pyetësorë gjithsej në nivel universiteti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

3.3 Anonimati i studentit

Përgjigjet e pyetësorit ruhen dhe përpunohen në mënyrë **Anonime**. Të dhënat janë hedhur në database nga stafi ndihmës akademik i DKSBC-së, si dhe mbi bazën e tyre janë hartuar të dhëna statistikore me qëllim evidentimin e problematikave kryesore të perceptuara nga studentët.

3.4 Kufizimet e vlerësimit

Gjatë procesit të realizimit të pyetësorit institucional, zyra e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë gjatë vitit akademik 2024 - 2025 u ndesh me kufizime teknike dhe metodologjike si më poshtë:

- Vlerësimi institucional është i kushtëzuar, pasi realizimi i pyetësorit është rastësor dhe i realizuar manualisht, që do të thotë se jo të gjithë studentët kanë qenë prezent ditën e realizimit të pyetësorit.
- Hedhja e të dhënave realizohet në mënyrë manuale duke rritur marzhin e gabimit në rezultatin përfundimtar.

❖ **Me qëllim përshkallëzimin e këtyre kufizimeve, rekomandohet:**

- Përgatitja e platformës në EMS për hedhjen e pyetësorit me qëllim plotësimin e tij nga të gjithë studentët, si dhe përpunimi i të dhënave drejtëpërdrejtë nga sistemi.
- Në çdo fillim viti akademik të organizohen takime me qëllim sensibilizimin e studentëve për rëndësinë e përfshirjes së tyre në vlerësimin ndaj institucionit dhe shërbimeve që ai ofron. Takimet të organizohen nga DKSBC në bashkëpunim me Njësitë Kryesore dhe Këshillin Studentor.

4. PËRFUNDIME dhe REKOMANDIME

Gjatë vitit akademik 2024 - 2025 në pyetësorin e studentëve për vlerësimin institucional, në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, në programet me karakter profesional dhe programet në të dy ciklet e studimit kanë marrë pjesë **20%** e studentëve, duke i bërë rezultatet e pyetësorit domethënëse për vlerësimin institucional.

☑ Nisur nga gjetjet, pas përpunimit të të dhënave, në njëzet e dy (22) pyetjet e mbyllura, studentët i kanë vlerësuar me **Mirë**, pra rezultatja e përgjithshme për **vlerësimin institucional** është **Mirë**.

Megjithatë, janë evidentuar problematika, të cilat shqetësojnë studentët, për pothuajse të gjitha programet e studimit, në të pesta Njësitë Kryesore, si më poshtë:

- Megjithëse studentët shprehen në masën **53%** se infrastruktura që UE ofron për procesin mësimor është **Mirë**, (Pyetja 4 në pyetësor), ato shprehen se mungon sistemi i ngrohjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

- Në të gjitha programet e studimit, dhe pse në përqindje të ndryshme, studentët evidentojnë si problematikë mungesën e integritetit të teorisë me praktikën. Studentët shprehen se orët e praktikës janë një domosdoshmëri për ta, me qëllim më pas integrimin me lehtësi në tregun e punës. *(Pyetja 21 në pyetësor).*
- Për shumë studentë, Këshilli Studentor duhet të jetë më gjithëpërfshirës, si dhe të jetë më aktiv në përcjelljen e zërit të tyre në organet dhe autoritetet drejtuese. *(Pyetja 12, 13, 14 në pyetësor).* Referuar të dhënave statistikore krahasuar me pyetësorin e vitit të kaluar, studentët kanë një rritje të kërkesës për tu përfshirë dhe shprehen për marrëdhënie më bashkëpunuese me organet vendimmarrëse dhe përfaqësuese të zërit studentor; përkatësisht *(pyetja 12)* viti akademik 2023 – 2024 **46%** e studentëve vlerësojnë **“Mirë”**, ndërsa viti akademik 2024 - 2025 **41%**; *(pyetja 14)* viti akademik 2023 - 2024 **40%** e studentëve vlerësojnë me **“Pak”**, ndërsa viti akademik 2024 - 2025 me **37%**;
- Sa i përket shërbimit të ofruar nga sekretaritë mësimore, edhe pse shërbimi vlerësohet **“Mirë”** me **46%**, *(Pyetja 3 në pyetësor)*, kërkohet më shumë gadishmëri dhe fleksibilitet ndaj studentëve. Referuar të dhënave statistikore krahasuar me pyetësorin e vitit të kaluar është ulur përqindja e kënaqësisë ndaj shërbimit të ofruar nga sekretaritë mësimore; përkatësisht viti akademik 2023 - 2024 **37%** e studentëve me **“Shumë mirë”**, ndërsa viti akademik 2024 – 2025 me **35%**.
- Në çdo Njësi Kryesore, shumica e studentëve shprehet për rritjen e mundësisë për të pasur akses në bibliotekën e fakultetit, si dhe për një literaturë më të pasur sa i përket fushës në të cilën ata studiojnë; përkatësisht *(pyetja 5)* viti akademik 2023-2024 **33%** e studentëve e vlerësojnë me **“Shumë mirë”**, ndërsa viti akademik 2024-2025 me **30%**.



Për sa më sipër rekomandojmë:

- Angazhimin e të gjithë strukturave përgjegjëse në sigurimin e lehtësirave infrastrukturore, bazës materiale dhe laboratorëve me qëllim përmirësimin e kushteve në auditore për një proces mësimor sa më efektiv si dhe krijimi i faciliteteve infrastrukturore për personat me aftësi të kufizuara.
- Organizimi i praktikave mësimore si një domosdoshmëri për të përvetësuar njohuritë e fituara gjatë viteve të studimit.
- Organet vendimmarrëse dhe përfaqësuese të zërit studentor të jenë më aktive dhe gjithëpërfshirëse.
- Organizimi i aktiviteteve nga universiteti me qëllim përfshirjen e sa më shumë studentëve në shërbimet akademike që ofron institucioni.
- Rritjen e gadishmërisë dhe fleksibilitetit të shërbimit të sekretarive mësimore përkundrejt studentëve.
- Biblioteka e çdo Njësie Kryesore të jetë e disponueshme dhe e pasur në literaturë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Krahas disa problematikave në përgjigjet e dhëna, studentët kanë shprehur dhe vlerësime pozitive.

- Ka një përmirësim të ndjeshëm të shkallës së kënaqësisë së studentëve për performancën e marrëdhënies së studentëve me stafin akademik. (vlerësohet me **49%**, **‘Shumë mirë’** dhe **47%**, **“Mirë”**).
- Vlen për tu përmendur, vlerësimi pozitiv, sa i përket metodologjisë së mësimdhënies; ku **48%** e studentëve e vlerësojnë me **“Shumë Mirë”**.
- Vlerësimi pozitiv, sa i përket procesit të hedhjes së notave në sistemin EMS, ku **45%** e studentëve e vlerësojnë me **“Shumë mirë”**.
- Është rritur informimi i studentëve lidhur me programet e studimit në fillim të vitit akademik; ku **40%** e studentëve e vlerësojnë me **“Shumë Mirë”**.

Raporti ka analizuar të dhënat e përfuara nga pyetësorët e realizuar në vitin akademik 2024 – 2025 për programet e studimit me karakter profesional, programeve të ciklit të parë “Bachelor” dhe ciklit të dytë të studimeve “Master” të përmbledhura në shtojca, pjesë përbërëse të këtij raporti, të cilat përkojnë me Njësitë Kryesore të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, si dhe në nivel institucioni.

❖ ***Për çdo Njësi Kryesore paraqiten rezultatet e pyetësorëve shprehur në përqindje dhe pasqyruar në grafikë bashkë me rekomandimet dhe sugjerimet përkatëse.***

5. SHTOJCA

- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (shtojca nr.1);
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës (shtojca nr. 2);
- Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë (shtojca nr. 3);
- Fakulteti i Shkencave të Edukimit (shtojca nr. 4);
- Fakulteti i Shkencave Humane (shtojca nr. 5);
- Në nivel institucioni (shtojca nr. 6);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Shtojca nr. 1. FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE.

1.1 Shpërndarja e pyetësorëve institucionalë sipas programeve të studimit, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Programet e studimit	Vitet
1.	Bachelor në “Infermieri e përgjithshme”.	II; III
2.	Bachelor në “Infermieri mami”.	II; III
3.	Bachelor në “Fizioterapi”.	II
4.	Bachelor në “Imazheri”.	III
5.	Bachelor në “Teknik laborator”.	II
6.	Master profesional në “Imazheri”.	I
7.	Master profesional në “Teknik laborator”.	I
8.	Master profesional në “Logopedi”.	I
9.	Master i shkencave në “Infermieri”.	I
10.	Master i shkencave në “Mami”.	I
11.	Master i shkencave në “Menaxhim infermieror”.	I

1.2 Përsa i takon komenteve të studentëve në lidhje me pyetjet e hapura, tek tabela e mëposhtme janë përmbledhur në mënyrë të strukturuar problematikat si më poshtë:

Problematikat FSHMT
1. Të ketë një bashkëpunim më të mirë me studentët dhe këshillin studentor. 2. Orë praktike të shtuara dhe bashkëpunim më korrekt të qendrave të spitaleve. 3. Shërbimi i ofruar nga sekretaritetë mësimore ka nevojë për përmirësim. 4. Të jetë funksional sistemi i ngrohjes. 5. Praktika gjatë masterit duhet të jetë më efektive dhe leksionet të jenë në koherencë me praktikën mësimore. 6. Stafi akademik të jetë më fleksibël në hedhjen e notave në sistem. 7. Disponibiliteti i bibliotekës dhe pasurimi i saj me literaturën e nevojshme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË


Tabela 1.3 Rezultatet të shprehura në përqindje për njëzet e dy (22) pyetjet e mbyllura, paraqiten si më poshtë:

Nr. Pyetjes në Pyetësor	PYETJET	ALTERNATIVAT			
		DOBËT	MIRË	SHUMË MIRË	NUK E DI
1	Si e vlerësoni marrdhënien midis studentëve dhe personelit akademik?	7%	58%	34%	1%
2	Si e vlerësoni marrdhënien midis studentëve dhe personelit ndihmësakademik (Laborantë, bibliotekarë, staf administrativ etj)?	15%	57%	24%	4%
3	Si e vlerësoni shërbimin e ofruar nga sekretaritetë mësimore?	31%	48%	18%	3%
4	Si e vlerësoni infrastrukturën që UE ofron për procesin mësimor?	17%	57%	23%	3%
5	Si e vlerësoni literaturën e disponueshme në bibliotekë?	17%	44%	26%	13%
6	Si e vlerësoni procesin e hedhjes së notave në sistemin EMS?	8%	48%	42%	2%
7	Si e vlerësoni sistemin e njoftimit në UE (website, afishim, rrjete sociale)?	12%	43%	40%	5%
8	Si e vlerësoni informacionin për mobilitetet e studentëve (programi ERASMUS +)?	11%	46%	24%	19%
9	Si e vlerësoni mundësinë që keni në aplikim për këto mobilitete?	10%	45%	23%	22%
10	Nëse keni qenë pjesë e mobiliteteve, si e vlerësoni përvojën e krijuar?	8%	27%	12%	53%
11	Si e vlerësoni transparencën e procesit të vendimmarrjes nga organet drejtuese të UE-së?	8%	59%	23%	10%
12	Si e vlerësoni marrdhënien me Këshillin Studentor?	21%	42%	21%	16%
15	Si e vlerësoni bashkëpunimin me Zyrën për Këshillimin e Karrierës?	19%	48%	16%	17%
17	Si i vlerësoni aktivitetet e ndryshme jomësimore që ofrohen nga UE?	20%	49%	20%	11%
19	Si e vlerësoni informacionin për programet e studimit në fillim të vitit akademik?	10%	55%	33%	2%
20	Si e vlerësoni metodologjinë e mësimdhënies?	7%	54%	37%	2%
21	Si e vlerësoni integrimin e teorisë me praktikën?	30%	41%	28%	1%
22	Si e vlerësoni përfshirjen e profesorëve të huaj në mësimdhënie ose leksione të hapura?	15%	43%	33%	9%

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË


		ASPAK	PAK	SHUMË MIRË	NUK E DI
13	Sa të përfaqësuar ndiheni nga strukturat studentore?	24%	46%	22%	8%
14	Sa përfaqësohet zëri i studentëve, apo përcillet në organet dhe autoritetet drejtuese?	23%	45%	22%	10%
16	Sa ju ka ndihmuar Zyra për Këshillimin e Karrierës me shërbime të ndryshme si këshillim, orientim apo informim?	22%	34%	25%	19%
18	Sa të përfshirë keni qenë ju në këto aktivitete jomësimore?	35%	42%	16%	7%

1.4 Përgjigjet të shpërndara sipas grafikëve si më poshtë:




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË


Grafiku 7: Si e vlerësoni sistemin e njoftimit në UE (website, afishim, rrjete sociale)?




Grafiku 8: Si e vlerësoni informacionin për mobilitetet e studentëve (programi ERASMUS +)?




Grafiku 9: Si e vlerësoni mundësinë që keni në aplikim për këto mobilitete?




Grafiku 10: Nëse keni qenë pjesë e mobiliteteve, si e vlerësoni përvojën e krijuar?




Grafiku 11: Si e vlerësoni transparencën e procesit të vendimmarrjes nga organet drejtuese të UE-së?




Grafiku 12: Si e vlerësoni marrëdhënien me Këshillin Studentor?



Grafiku 13: Sa të përfaqësuar ndiheni nga strukturat studentore?




Grafiku 14: Sa përfaqësohet zëri i studentëve, apo përcillet në organet dhe autoritetet drejtuese?




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË


Grafiku 15: Si e vlerësoni bashkëpunimin me Zyrën për Këshillimin e Karrierës?




Grafiku 16: Sa ju ka ndihmuar Zyra për Këshillimin e Karrierës me shërbime të ndryshme si këshillim, orientim apo informim?




Grafiku 17: Si i vlerësoni aktivitetet e ndryshme jomësimore që ofrohen nga UE?




Grafiku 18: Sa të përfshirë keni qenë ju në këto aktivitete jomësimore?




Grafiku 19: Si e vlerësoni informacionin për programet e studimit në fillim të vitit akademik?




Grafiku 20: Si e vlerësoni metodologjinë e mësimdhënies?



Grafiku 21: Si e vlerësoni integrimin e teorisë me praktikën?



Grafiku 22: Si e vlerësoni përfshirjen e profesorëve të huaj në mësimdhënien ose leksione të hapura?





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Shtojca nr. 2. FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS.

2.1 Shpërndarja e pyetësorëve institucionalë sipas programeve të studimit, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Programet e studimit	Vitet
1.	Program studimi me karakter profesional në “ Teknologji laborator ”.	I; II
2.	Program studimi me karakter profesional në “ Mekatronikë ”.	I; II
3.	Program studimi me karakter profesional në “ Logjistikë ”.	I; II
4.	Program studimi me karakter profesional në “ Teknik mjedisi ”.	I; II
5.	Bachelor në “ Biologji kimi ”.	I; II; III
6.	Bachelor në “ Matematikë fizikë ”.	I; II; III
7.	Bachelor në “ Teknologjitë e informacionit ”.	I; II; III
8.	Master profesional në “ Analist prodhimi ”.	I; II
9.	Master i shkencave në “ Mbrojtje mjedisi ”.	I

2.2 Përsa i takon komenteve të studentëve në lidhje me pyetjet e hapura, tek tabela e mëposhtme janë përmbledhur në mënyrë të strukturuar problematikat si më poshtë:

Problematikat FSHN
1. Të ketë një bashkëpunim më të mirë me studentët dhe këshillin studentor. 2. Integrimi i teorisë me praktikën. 3. Shërbimi i ofruar nga sekretaritetë mësimore ka nevojë për përmirësim. 4. Të jetë funksional sistemi i ngrohjes. 5. Disponibiliteti i bibliotekës dhe pasurimi i saj me literaturën e nevojshme. 6. Laboratorët të jenë më funksionalë dhe më të pasur në bazën materiale.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË


Tabela 2.3 Rezultatet të shprehura në përqindje për njëzet e dy (22) pyetjet e mbyllura, paraqiten si më poshtë:

Nr. Pyetjes në Pyetësor	PYETJET	ALTERNATIVAT			
		DOBËT	MIRË	SHUMË MIRË	NUK E DI
1	Si e vlerësoni marrëdhënien midis studentëve dhe personelit akademik?	2%	38%	59%	1%
2	Si e vlerësoni marrëdhënien midis studentëve dhe personelit ndihmës akademik (Laborantë, bibliotekarë, staf administrativ etj)?	2%	36%	59%	3%
3	Si e vlerësoni shërbimin e ofruar nga sekretaritë mësimore?	4%	36%	56%	4%
4	Si e vlerësoni infrastrukturën që UE ofron për procesin mësimor?	3%	42%	47%	8%
5	Si e vlerësoni literaturën e disponueshme në bibliotekë?	6%	36%	34%	24%
6	Si e vlerësoni procesin e hedhjes së notave në sistemin EMS?	3%	34%	50%	13%
7	Si e vlerësoni sistemin e njoftimit në UE (website, afishim, rrjete sociale)?	7%	39%	44%	10%
8	Si e vlerësoni informacionin për mobilitetet e studentëve (programi ERASMUS +)?	3%	42%	31%	24%
9	Si e vlerësoni mundësinë që keni në aplikim për këto mobilitete?	4%	46%	30%	20%
10	Nëse keni qenë pjesë e mobiliteteve, si e vlerësoni përvojën e krijuar?	3%	33%	19%	45%
11	Si e vlerësoni transparencën e procesit të vendimmarrjes nga organet drejtuese të UE-së?	4%	50%	33%	13%
12	Si e vlerësoni marrëdhënien me Këshillin Studentor?	8%	41%	37%	14%
15	Si e vlerësoni bashkëpunimin me Zyrën për Këshillimin e Karrierës?	8%	50%	27%	15%
17	Si i vlerësoni aktivitetet e ndryshme jomësimore që ofrohen nga UE?	14%	40%	27%	19%
19	Si e vlerësoni informacionin për programet e studimit në fillim të vitit akademik?	4%	50%	43%	3%
20	Si e vlerësoni metodologjinë e mësimdhënies?	5%	35%	57%	3%
21	Si e vlerësoni integrimin e teorisë me praktikën?	8%	45%	44%	3%
22	Si e vlerësoni përfshirjen e profesorëve të huaj në mësimdhënie ose leksione të hapura?	9%	35%	43%	13%

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË


		ASPAK	PAK	SHUMË MIRË	NUK E DI
13	Sa të përfaqësuar ndiheni nga strukturat studentore?	10%	36%	40%	14%
14	Sa përfaqësohet zëri i studentëve, apo përcillet në organet dhe autoritetet drejtuese?	10%	30%	40%	20%
16	Sa ju ka ndihmuar Zyra për Këshillimin e Karrierës me shërbime të ndryshme si këshillim, orientim apo informim?	9%	37%	37%	17%
18	Sa të përfshirë keni qenë ju në këto aktivitete jomësimore?	21%	39%	27%	13%

2.4 Përgjigjet të shpërndara sispas grafikëve si më poshtë:




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
